



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



KOMISIONI RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK
PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2022

Nëntor 2021

Përmbajtja

SHKURTESAT.....	3
1 HYRJE	4
2 MANDATI I KOMISIONIT RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK	5
2.1 Organizimi i KRPP-së.....	6
2.2 Struktura organizative aktuale e KRPP-së.....	8
3 FINANCIMI I KOMISIONIT RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK	11
3.1 Planifikimi i të hyrave të KRPP-së	11
3.2 Të hyrat dhe Shpenzimet	12
3.3 Donacionet	13
4 Shtojca I - Plani i Përformancës	14

SHKURTESAT

KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
EU	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
AKK	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
KKPP	Këshilli Kombëtar për Prokurim Publik
OSHP	Organi Shqyrtues për Prokurim
AMB	Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar

1 HYRJE

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) është themeluar në vitin 2004, sipas LPP Nr.2003/17. Aktualisht përgjegjësit e saja rregullohen me Ligjin Nr. 04/1-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.KRPP-ja .

KRPP-ja luan rol të rëndësishëm në funksionimin e sistemit të prokurimit publik i cili paraqet një çështje thelbësore të menaxhimit të financave publike për administratën publike në Kosovë dhe një sistem i mirëfilltë i prokurimit publik mundëson shfrytëzimin më efikas dhe më të arsyeshëm të fondeve publike, duke mundësuar kursime substanciale të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe duke kontribuar ndjeshëm në luftimin e korrupsionit, keqpërdorimeve e njëkohësisht edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës l

Plani i përformancës i KRPP-se zhvillohet mbi baza vjetore ose në një periudhë afatmesme, në varësi të nevojave/kërkesës për krijimin e një vizioni më të qartë për trendët e zhvillimit të sektorit të prokurimit publik në Kosovë dhe më gjerë. Ky plan mbulon periudhën 1-vjeçare, kryesisht duke renditur objektiva dhe aktivitete që do të zhvillohen, por edhe kërkesa ligjore dhe strategjike të sektorit të prokurimit, krahas Strategjisë kombëtare për prokurim publik dhe Planit të Zbatimit të Strategjisë Kombëtare. Kërkesa për një Plan të Përformancës së KRPP-së, përveç që është një kërkesë ligjore, është mjaft e nevojshme, duke marrë parasysh të gjitha ndryshimet në sektorin e prokurimit, të cilat pritet të sjellin një transformim të rëndësishëm në sistemin e prokurimit publik.

Plani i Përformancës ka për qëllim zhvillimin e mekanizmave për respektimin e afateve dhe procedurave si një përpjekje për të realizuar qëllimet operative:

- a. Përshkrimi i objektivave dhe qëllimeve të Planit të Veprimit;
- b. Rezultatet e pritura;
- c. Renditja e veprimeve të nevojshme;
- d. Përcaktimi i mjeteve të veprimit;
- e. Marrëdhënia ndërmjet veprimeve të tilla (nëse aplikohet); dhe
- f. Afatet e veprimit;

Plani i Përformancës është një faktor i rëndësishëm përcaktues për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore të përcaktuara me Nenin 87 të Ligjit për Prokurim Publik, si dhe për planifikimi e shpenzimeve të KRPP-se. Gjithashtu ky plan është përgatitur sipas kërkesave të nenit 43 pika 3 të Ligjit Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Ligji Nr.06/-113).

Publikimi i këtij Plani të Punës do të fuqizojë transparencën dhe përgjegjshmërinë, duke lejuar të gjithë palët e interesit të sigurojnë që aktivitetet e planifikuara për çdo vit radhazi të jenë në përputhje me detyrat ligjore dhe funksionet e KRPP-së.

2 MANDATI I KOMISIONIT RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), është agjencia e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, sipas Nenit 142 (Kapitulli XII) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KRPP si njëra nga Institucionet qendrore të Prokurimit Publik, është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe duke u bazuar në përgjegjësi të saja KRPP-ja ka përcaktuar objektiva konkrete në këtë fushë. Objektivi dhe synimi kryesorë i KRPP-së, ka qenë dhe mbetet avancimi i sistemit të prokurimit publik në Kosovë, me qëllim të ngritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies nga të gjithë aktorët të cilët janë të përfshirë në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik. Funksionimi i sistemit të prokurimit publik paraqet një çështje thelbësore të menaxhimit të financave publike për administratën publike në Kosovë dhe një sistem i mirëfilltë i prokurimit publik mundëson shfrytëzimin më efikas dhe më të arsyeshëm të fondeve publike, duke mundësuar kursime substanciale të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe duke kontribuar ndjeshëm në luftimin e korrupsionit, keqpërdorimeve e njëkohësisht edhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Për me tepër, objektivat specifike të KRPP janë:

- Përmirësimi i përgjegjësisë, integritetit, llogaridhënies, kontrollit për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në prokurim publik.
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i prokurimit elektronik.

- Të siguroj përputhshmërinë e vazhdueshme me kornizën ligjor të BE-së duke shfrytëzuar përvojën dhe praktikën më të mira të shteteve anëtare të BE-së në fushën e prokurimit publik.
- Të rris efikasitetin në sistemin e Prokurimit Publik përmes vendosjes së rregullave dhe monitorimit të zbatimit të tyre si dhe siguroj zbatimin e parimit të transparencës dhe qasjes në informata në të gjitha fazat e aktivitetit të prokurimit gjatë përdorimit të fondeve publike.
- Të trajnoj dhe të zhvillojë kuadro profesionale të prokurimit në sektorin e prokurimit publik për tu përballuar me një treg në rritje të prokurimit dhe rolin e tij të pritur në zhvillimin ekonomik kombëtar.
- Komunikimi dhe ngritja e vetëdijes për prokurimin publik në Kosovë.

Funksionet/përgjegjësit kryesore të KRPP-së janë të detajuara në Nenin 87 të Ligjit për Prokurim Publik dhe mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Përgjegjësia Ligjore;
- Përgjegjësia e Monitorimit;
- Përgjegjësia e Trajnimit;
- Përgjegjësia e Revokimit të Certifikatave të prokurimit;
- Përgjegjësia e zhvillimit të prokurimit elektronik;
- Përgjegjësia e nder veprimit dhe bashkëpunimit me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.

2.1 Organizimi i KRPP-së


Struktura organizative e KRPP-së është përcaktuar nga Bordi i KRPP-së, në bazë të përgjegjësiave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Prokurim Publik .

Në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, KRPP-ja udhëhiqet nga Kryetari i Bordit të KRPP-së. Ndërsa Bordi është përgjegjës për miratimin e politikave, aprovon raportin vjetor të prokurimit publik për Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës, të përgadit dhe aprovoj strategjinë dhe planin e veprimit të sistemit të prokurimit publik të Republikës së Kosovës, të përgadit dhe aprovoj në baza vjetore strategjinë dhe planin e veprimit për punën e tij, të nxjerr dhe aprovon rregullore të legjislacionit sekondar për sistemin e prokurimit dhe punës të KRPP-së.

Struktura themelore organizative e KRPP-së përbëhet nga Bordi, katër departamente, nëntë divizione .Secili departament, përbëhet nga dy divizione :

- a. Departamenti i Rregullave (DRr)
- b. Departamenti i Monitorimit(DM)
- c. Departamenti për trajnime dhe Integritet(DTI)
- d. Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik(DSPE)
- e. Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP)
- f. Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore(ZPMBNJ)
- g. Zyrtari Përgjegjës për Prokurimit (ZPP)
- h. Zyrtari Përgjegjës për Financa (ZPF)

2.2 Struktura organizative aktuale e KRPP-së



Departamenti i Rregullave (DRR)

Departamenti i Rregullave do të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin e LPP si dhe interpretime në fushën e prokurimit publik si dhe nxjerrjen e formularëve dhe përgatitjen e legjislacionit sekondar, me anë të të cilave do të arrihet përmirësimi i përgjegjesisë, integritetit, llogaridhënies, kontrollit për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në prokurim publik .

Departamenti i Monitorimit (DM)

Departamenti i Monitorimit do të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të LPP dhe rregullave të nxjerra nga KRPP sipas autorizimit të LPP-së, përmes monitorimit do të arrihet rritja e efikasitetin në sistemin e Prokurimit Publik përmes monitorimit të zbatimit të rregullave të vendosura si dhe zbatimi në parim të transparencës dhe qasjes në informata në të gjitha fazat e aktivitetit të prokurimit gjatë përdorimit të fondeve publike.

Departamenti për trajnime dhe Integritime(DTI)

Departamenti për trajnime dhe Integritime do të zhvillojë dhe organizoj trajnimet për programin Themelore Profesional dhe për programin e Avancuar profesional për prokurim sipas LPP si dhe për çështjet që lidhen me prokurimin publik sa i përket procesit të Integritetit Evropian , ku përmes trajnimeve do të arrihet zhvillimi i kuadrove profesionale të prokurimit në sektorin e prokurimit publik për tu përballuar me një treg në rritje të prokurimit dhe rolin e tij të pritur në zhvillimin ekonomik kombëtar.

Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik(DSPE)

Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik do të udhëheqë dhe administroj të gjitha shërbimet e TI-së që janë në funksion të sistemit të prokurimit elektronik , ku përmes e-prokurimit do të arrihet modernizimi i vazhdueshëm i sistemit të prokurimit përmes efikasiteti dhe transparencës dhe do të shërbeje për rritjen e efektivitetit gjatë zbatimit të ligjit të prokurimit.

Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP)

Divizioni i shërbimeve të përbashkëta mbështet funksionimin e KRPP-së, duke siguruar furnizimin dhe mirëmbajtjen e furnizimeve për zyra, duke ofruar ndihmë logjistike për takimet e personelit të KRPP-se, duke mirëmbajtur dhe administruar

sistemin e arkivit të KRPP dhe ndihmon në rregullimin e zyrave, dhënien e hapësirave të zyrave të përshtatshme për përdorim nga stafi i KRPP-së .

Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore(ZPMBNJ)

Zyra për menaxhimin e burimeve njerëzore ka mision zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe procedurave lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Zyrtari për menaxhim të burimeve njerëzore do të bëjë Analizimin e nevojave të punësimit, zhvillimi i planit të personelit, koordinimi dhe sigurimi i procesit të rekrutimit si dhe përgatitja e përshkrimeve të punës. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për zhvillimin e kapaciteteve të personelit, sigurimi i trajnimeve adekuate dhe vlerësimi i ndikimit të trajnimeve, Sigurimi i realizimit dhe mbrojtja e të drejtave të punësuarave sipas legjislacionit në fuqi.

Zyrtari Përgjegjës për Prokurimit

Zyra e prokurimit ka mision të siguron që të gjitha aktivitetet e prokurimit të institucionit të jenë në pajtim me dispozitat e legjislacionit dhe rregullave të prokurimit si dhe zhvillimin e strategjive dhe dokumenteve të prokurimit.

Zyrtari përgjegjës për Financa

Zyrtari përgjegjës për financa koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat organizative të KRPP-se, siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore si dhe raporton mbi ekzekutimin buxhetor.

3 FINANCIMI I KOMISIONIT RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, KRPP-ja gëzon statusin e " agjencionit të pavarur". Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon që agjencitë e pavarura, janë institucione të krijuara nga Kuvendi bazuar në ligjet përkatëse që rregullojnë krijimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës. Kjo do të thotë që KRPP-ja duhet të ketë pavarësi të plotë në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit, gjegjësisht të hyrave të dedikuara të saj, të garantuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Çështja e pavarësisë financiare është rregulluar kryesisht nga Direktivat e BE-së, të cilat parashikojnë që shtetet anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet rregullative ose agjencitë e pavarura duhet të jenë në gjendje të marrin vendime autonome në mënyrë të pavarur nga çdo organ politik, përfshirë mënyrat përmes të cilave ato ushtrojnë mandatet e tyre, njerëzit që duhet të rekrutojnë etj. Kjo do të thotë që KRPP-ja duhet të gëzojë pavarësi financiare.

3.1 Planifikimi i të hyrave të KRPP-së

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KRPP-ja është një agjenci jofitimprurëse dhe duke pasur parasysh këtë status, të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në këtë Plan kanë për qëllim zgjerimin e të dhënave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e KRPP-së, por jo për rezultatet financiare, sepse është e qartë se KRPP-ja nuk është një organizatë fitimprurëse.

<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2021</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2022</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2023</i>
NA	NA	NA

3.2 Të Hyrat dhe Shpenzimet

Buxheti i planifikuar i KRPP-së, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, është si me poshtë .

	<i>Viti 2021</i>	<i>Viti 2022</i>	<i>Viti 2023</i>
Totali	699,976	775,712	883,493
Nr. i punëtorëve	42	42	45
Pagat dhe Mëditjet	369,611	373,999	399,240
Mallrat dhe Shërbimet	275,365	296,713	299,253
Shpenzimet Komunale	5,000	5,000	5,000
Subvencionet dhe Transferet	-		
Shpenzimet Kapitale	50,000	150,000	180,000
Burimet e Buxheti i Kosovës Financimit			
Grantet qeveritare	00		
Të hyrat vetanake	00		
Financimet nga huamarrjet	0.00	0.00	0.00
Grantet nga donatorët	0.00	0.00	0.00

3.3 Donacionet

KRPP- ja ka gëzuar mbështetje të fortë të donatorëve në vazhdimësi, kryesisht në ofrimin e asistencës dhe shërbimeve të konsulencës dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale të KRPP-se, për përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive të saj. Në kuadër të mbështetjes së donatorëve në vitet e fundit duhet theksuar mbështetjen e USAID (nëpërmjet projektit TEAM) e cila mbështetje ka qenë e fokusuar në ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit në AK, përfshirë mbështetjen me asistencë teknike dhe financiare në komponenten e prokurimit elektronik si dhe mbështetja e projektit të EU-se për përgatitje të Draftit për Ligj të Ri të Prokurimit Publik.

Bazuar në bashkëpunimin aktual të KRPP-së me institucionet ndërkombëtare dhe objektivat e përkrahjes së këtyre institucioneve ndërkombëtare në fushën e prokurimit publik, planifikohet që edhe gjatë vitit 2022 të vazhdohet bashkëpunimi dhe përkrahja konkrete nga donatorët si USAID, EU, SIGMA, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar (UK), Qeverisë së Luksemburgut, etj.

USAID me përfundim të projektit TEAM do vazhdojë përkrahjen për KRPP-në edhe gjatë vitit 2022 nëpërmjet projektit të ri si vazhdimësi e TEAM. Përkrahja e projektit të USAID do të fokusohet në pjesën e avancimit të sistemit të prokurimit elektronik, në ngritje të kapaciteteve të prokurimit për AK-në dhe në rritjen e llogaridhënies në prokurim publik.

EU nëpërmjet projektit për reformë të menaxhimit të financave publike (të implementuar nga GIZ), bazuar në planin e aktiviteteve të projektit edhe me tuje do të vazhdojë ofrimin e përkrahjes së asistencës teknike në fushën e legjislacionit primarë dhe sekondarë, në veçanti fokus do jetë legjislacioni sekondar pas miratimit të Ligjit të Ri për prokurim publik.

Derisa, gjatë vitit 2022 koordinimi dhe përkrahja e KRPP-se me donatore do të përfshijë edhe bashkëpunimin me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar (UK), me të cilët KRPP ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për implementim të projektit për avancim të modulit të OSHP-së brenda sistemit të prokurimit elektronik. Ky projekt parashikohet që të përmbyllet brenda vitit 2022.

Duhet theksuar që përkrahja e donatorëve USAID, EU dhe UK nëpërmjet projekteve të tyre do të luaj një rol kyç për KRPP-në në arritjen e objektivave dhe prioriteteve të planifikuara për vitin 2022 dhe të cilat janë prezantuar në shtojcën I.

4 Shtojca I - Plani i Përformancës

17	18 Prioritetet/Objektivat	19 Aktivitetet/Veprimet	Rezultatet e pritura	Afatet kohore	Vlerësimet buxhetore	Palët e përfshira
1	Përditësimi i kornizës ligjore te prokurimit publik – me fokus legjislacionin sekondar	<ul style="list-style-type: none"> - Analizim dhe vlerësim i nevojave për përditësim te kornizës ligjore, bazuar ne: kërkesat për interpretim ligjor drejtuar KRPP-se, mangësitë e evidentuara nga monitorimi i KRPP-se, zhvillimeve ne prokurim elektronik dhe bazuar ne kërkesat nga Ligji i ri i Prokurimit Publik pas aprovimit. - Plotësim-ndryshimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe i akteve tjera dytësore. - Rishikim dhe përditësim i pyetjeve të shpeshta –aktualisht te publikuara nga KRPP. 	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillim i aktiviteteve të prokurimit në mënyrë me efikase dhe efektive; - Rregulla dhe dokumente standarde te prokurimit publik te përshtatura me legjislacion primar dhe avancimet e prokurimit elektronik; - Ulje e kërkesave ne ofrim te këshillave/interpretimeve për zbatimin e LPP dhe legjislacionit dytësor; - Pyetje te shpeshta te strukturuara ne pajtim me legjislacionin aktual 	Janar-dhjetor 2022	S'ka implikime buxhetore nga KRPP	KRPP, donatoret
2	Monitorim te aktiviteteve te prokurimit dhe administrimit te menaxhimit te kontratave	- Finalizim dhe implementim te veglës/aplikacionit softuerik te zhvilluar nga projekti TEAM/USAID;	- Monitorim ne kohe reale i aktiviteteve te prokurimit për të cilat kërkohet intervenim nga monitorimi dhe adresim	Janar-dhjetor 2022	S'ka implikime buxhetore nga KRPP	KRPP

		<ul style="list-style-type: none"> - Vënia në përdorim të veglës nga ana e zyrtarëve të monitorimit për monitorim të aktiviteteve të prokurimit që nga faza e inicimit bazuar në indikatore të përzgjedhur dhe me prioritet; - Përdorim i shtuar i veglave për menaxhim të kontratave dhe vlerësimit të performancës së kontraktuesve nga ana e zyrtarëve të monitorimit. - Analizim dhe përpunim i të dhënave nga sistemi i prokurimit elektronik për të adresuar mangësitë e zyrtarëve të prokurimit të AK-së në zbatim të drejtë të LPP 	<ul style="list-style-type: none"> nga ana e AK-së; - Llogaridhënie e shtuar në prokurim publik nga ana e AK-së; - Prioritizim i treguesve për monitorim sipas peshës dhe rëndësisë; - Kategorizim apo selektim i AK-së për monitorim për secilin zyrtar të monitorimit; - Të dhëna dhe regjistër i saktë i AK-se prej të cilave është kërkuar intervenim dhe adresim i gjetjeve të monitorimit - Ulje e numrit të kontratave të nënshkruara të cilat implementohen pa Plan për menaxhim të Kontratës dhe pa të dhëna rreth progresit të implementimit të kontratës; - Rritja e numrit të kontratave të vlerësuara në performance të implementimit dhe rritja e numrit të kontraktuesve me histori të performimit në kontratat e implementuara. 			
3	Operim i pandërprere dhe plotësisht funksional i platformës së prokurimit	<ul style="list-style-type: none"> - Vazhdimi i kontraktimit për mirëmbajtje të sistemit të prokurimit elektronik 	<ul style="list-style-type: none"> - Realizim i aktiviteteve të prokurimit nga ana e AK-se pa probleme dhe në kohë; 	Janar-dhjetor	150,000 Euro	KRPP, ASHI, MFPT

	elektronik	<ul style="list-style-type: none"> - Vazhdimi në ngritjen e kapaciteteve harduerike në infrastrukturën e sistemit të prokurimit elektronik – pjesa e sajtit sekondar - Bashkëpunim me institucionet (ASHI/MPB dhe ATK) me sistemet e të cilave sistemi i prokurimit elektronik ndërvepron. 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrje e sigurt dhe e lehtësuar e OE në aktivitete të prokurimit, pa diskriminim dhe plotësisht transparent - Transparence dhe disponueshmeri në kohë reale e të dhënave të prokurimit për të gjitha palët e interesuara 	2022		
4	Avancim i platformës se prokurimit elektronik me modulin e përditësuar të OSHP-se nëpërmjet projektit të ambasadës se Mbretërisë së Bashkuar	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e Termave të Referencës dhe specifikimeve teknike në koordinim me OSHP dhe projektin e ambasadës se UK. - Lidhja e kontratës me kontraktuesin për zhvillim dhe implementim te projektit; - Implementim i përditësimeve te modulis te OSHP-se ne ambientin testues dhe ambientit real, përfshirë trajnimin e përdoruesve te modulis si nga ana e AK-se, OE dhe OSHP-se. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorim i plotë i modulis të ankesave nga ana e OSHP-se; - Përmirësim dhe lehtësim i proceseve të punës dhe hapave për shqyrtim të ankesave ne aktivitete te prokurimit, që nga përgatitja dhe dorëzimi i ankesës nga OE deri në nxjerrje të vendimit nga ana e OSHP-së; - Të dhëna të detajuara dhe në format të lexueshëm për ankesat e dorëzuara dhe shqyrtuara; - Rritje e transparencës në të dhënat e ankesave të dorëzuara dhe shqyrtuara; 	Janar-Dhjetor2022	S’ka implikime buxhetore nga KRPP.	KRPP, OSHP dhe projekti i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar

5	Avancimi i sistemit të prokurimit elektronik në nderveprueshmeri me SIMFK – Thesarin/MFPT	<ul style="list-style-type: none"> - Koordinim i grupeve punuese të KRPP-se dhe MFPT për draftim dhe finalizim të specifikimeve teknike për nderveprueshmeri të dy sistemeve; - Kontraktimi i punëve për ndryshimet/përditësimet në të dy sistemet – me kontraktuesit për sistemet përkatëse; - Zhvillimi dhe implementimi i ndryshimeve/përditësimeve nga ana e dy sistemeve; - Testimi i nderveprueshmerise në ambientet testuese dhe realizimi i trajnimeve përkatëse; - Implementimi i nderveprushmerise se dy sistemeve në ambientet reale; 	<ul style="list-style-type: none"> - Kontroll i automatizuar i disponueshmerise së mjeteve dhe nevojave gjatë inicimit të aktiviteteve të prokurimit nga ana e AK-së; - Të dhëna të detajuara dhe në kohë reale për statusin e aktiviteteve të prokurimit për të cilat janë zotuar mjete financiare; - Të dhëna të detajuara dhe transparente për statusin e kontratave ne implementim dhe gjendjen e pagesave për kontratat të cilat paguhen nga buxheti i Kosovës; - Përmirësim në të dhënat e kontratave shumëvjeçare ne implementim – të dhëna të cilat shfrytëzohen për përgatitje dhe ekzekutim të buxhetit te Kosovës nga ana e MFPT-së. 	Janar – dhjetor 2022	50,000 Euro	KRPP, MFPT- Thesari, donatoret
---	---	---	---	----------------------	-------------	--------------------------------

6	Avancimi në hapje të të dhënave të prokurimit publik – përfshirje e të dhënave të hapura për kontratat në implementim	<ul style="list-style-type: none"> - Avancim i Ueb aplikacionit për publikim të të dhënave sipas standardit për të dhëna të hapura edhe me të dhënat e kontratave në implementim – përveç të dhënave të prokurimit; - Publikimi i ndryshimeve në ueb-aplikacion dhe dhënia e instruksioneve për përdorim nga të gjitha palët e interesuara 	<ul style="list-style-type: none"> - Të dhëna të publikuara për të gjitha fazat e aktivitetet të prokurimit të zhvilluara nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, përfshire të dhënat nga kontratat në implementim; - Të dhënat e publikuara të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave në implementim, janë plotësisht transparente, të lexueshme dhe në dispozicion për shfrytëzim nga të gjitha palët e interesuara. 	Janar-prill 2022	S'ka implikime buxhetore nga KRPP	KRPP
7	Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve	<ul style="list-style-type: none"> - Rishikim i programeve/moduleve të trajnimit për nivele bazike dhe të avancuara të trajnimit; - Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik; - Planifikim dhe organizim i trajnimeve për nivel bazik dhe të avancuar në prokurim publik 	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e numrit të zyrtareve/personave të pajisur me certifikate të avancuar të prokurimit; - Plotësimi i nevojave të AK-së për zyrtare të certifikuar në prokurim publik. 	Janar – dhjetor 2022	S'ka implikime buxhetore	KRPP, IKAP
8	Bashkëpunimi ,prezantim dhe raportim i zhvillimeve, të arritave dhe sfidave në fushën e prokurimit publik	<ul style="list-style-type: none"> - Angazhimi i një zyrtari të dedikuar për informim dhe bashkëpunim ndërinstitucional - Koordinim dhe takime të rregullta të udhëheqësve të departamenteve dhe zyrtareve për informim dhe integrim 	<ul style="list-style-type: none"> - Informim në kohë reale i publikut mbi zhvillimet në prokurim publik; - Të dhëna të sakta mbi të arriturat në kapitujt e prokurimit publik të 	Janar-dhjetor 2022	S'ka implikime buxhetore	KRPP, AKK , KKPP

		<p>për analizim dhe grumbullim të të dhënave për të arriturat në departamentet përkatëse;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raportim i rregullt mbi të arriturat në prokurim publik për raportimet vendore dhe ndërkombëtare; - Organizimi i tryezave mbi të arriturat dhe sfidat në prokurim publik. 	<p>raporteve vendore dhe ndërkombëtare;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritje e imazhit të institucionit (KRPP-se) dhe institucioneve qeveritare në raport me publikun. 			
--	--	--	---	--	--	--